

futën në veturë të tipit *Lada* dhe e dërguan në drejtim të panjohur. Familja me vite të tëra e ka kërkuar Vehbiun. Zhdukjen e tij e kanë paraqitur në organizatat e shumta. Në tetor të vitit 2007, familja ka mësuar se mbetjet mortore të Vehbiut janë identifikuar më 15.08.2000, në varrezën masive në Makërmal/Makrmal [Skënderaj/Srbica]. Familja i ka varrosur mbetjet mortore të Vehbiut më 15.10.2007, në varrezat e Çitakut/Çitak.

Burimet: deklarata F.H, FDH-20301; SMIP, *Teroristički...*, III, 968.

Reshat (Bajram) Qerkinaj

(26.09.1970, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica)

Reshatin e kishin parë për herë të fundit më **4.08.1998** në **Mitrovicë/Kosovska Mitrovica**. Zhdukja e tij në regjistrin e KNKK-së është evidentuar me numër BLG-802649-01.

Burimi: KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Ruzhdi (Kajtaç) Beci

(21.08.1970, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, tregtar, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së) Ruzhdiu ishte i sistemuar në shtabin e UÇK-së në fshatin Likoc/Likovac [rajoni i Drenicës/Drenica]. Në datën **26.08.1998**, Ruzhdiu gjendej për vizitë te i vëllai Qamili në **Vaganicë/Vaganica**. Pasdite, Ruzhdiu doli nga shtëpia dhe nuk u kthye kurrë më. Nga ai çast atij i humbet çdo gjurmë. Në regjistrin e KNKK-së, zhdukja e Ruzhdiut është e evidentuar me numrin BLG-802826-01.

Burimet: deklarata B.B, FDH-29844; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Selim (Jashar) Segaçi

(11.12.1932, shqiptar nga Pirqi/Pirçe, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, minator, shtatë fëmijë)

Në fund të muajit gusht të vitit 1998, banorët e fshatit Pirq/Pirçe i braktisën shtëpitë e veta. Forcat serbe e kishin vendosur rrethimin e fshatit. Bashkëshortja e Selimit, i biri, e reja dhe nipat kishin

shkuar më 28.08.1998 në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Selimi mbeti në shtëpi. Të nesërmen, i biri dhe e reja u kthyen në fshat, me qëllim që ta bindnin Selimin ta braktiste fshatin, por ai sërish refuzoi që të largohej nga shtëpia. Në datën **2.09.1998**, familjarët mësuan nga mediat se forcat serbe në atë ditë kishin hyrë në fshat dhe se Selimi ishte vrarë në oborrin e shtëpisë [**Pirq/Pirçe**]. Dy javë më vonë, i biri i Selimit arriti që të hynte në fshat dhe nga ushtarët e UÇK-së ka mësuar se ata e kishin varrosur Selimin në oborrin e shtëpisë më 2.09.1998. Në datën më 16.09.1998, i biri i Selimit i ka rivarrosur mbetjet mortore të të atit në varrezat në Pirq/Pirçe.

Burimet: deklarata M.S, FDH-17373; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor FDH-29762.

Tadija (Relja) Radivojević

(8.10.1954, serb nga Frashri i Madh/Svinjare, komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, vozitës)

Tadija punonte si vozitës i ambulancës në kombinatin *Trepça/Trepça* në **Stantërg/Stari Trg**. Ai gjeti vdekjen në pasditen datës **9.09.1998**, përderisa ishte kujdestar në *Trepça/Trepça* kur ndaj tij ka shtënë një rezervistë i UJ-së nga fshati Sento [Zvečan/Zvečan]. Ata që të dy i hapën përnjëherë dyert e kundërta të sallës së këshillit të punëtorëve. Nga frika, rezervisti shtëni menjëherë dhe e vrau Tadijen në vend. Tadijen e kanë varrosur më 10.09.1998 në varrezat ortodokse në Frashrin e Madh/Svinjare.

Burimet: deklarata V.D, FDH-36832; USCG KGDH, *Regjistri...*, 29, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 488.

Marinko (Tomislav) Kandić

(2.02.1965, serb nga Kërstoci/Krstovac, komuna e Pejës/Peç, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Marinko u lind në fshatin Meteh, komuna e Plavit, në Malin e Zi. Nga viti 1991, punonte si polic në stacionin policor në Klinë/Klina. Në datën **15.09.1998**, rreth orës 16:45, Marinko e humbi jetën në **Mazhiq/Mažić**,